



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 07, datë 20.06.2018

**PËR**


**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“DEPO QËNDRORE E BARNAVE DHE MATERIALEVE MJEKËSORE NË QENDRËN**  
**SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Depo qëndrore e barnave dhe materialeve mjekësore në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT).
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

OGERTA MANASTIRLIU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

